



Ndikimi i ndihmës shtetërore në tregun e energjisë elektrike në Ballkan

Shkurt 2019

Përmbajtja

1.	Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike në BE	6
2.	Rregullat e Ndhmës Shtetërore	10
	2.1. Ndhma Shtetërore sipas BE dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë	10
	2.2. Ndhma Shtetërore	12
	2.3. Pasojat juridike të mospajtueshmërisë me rregullat e BE-së dhe TKE-së për Ndhmën Shtetërore	13
	2.3.1. Mospajtueshmëria me rregullat e BE-së për Ndhmën Shtetërore	13
	2.3.2. Mospajtueshmëria me rregullat e TKE për Ndhmën Shtetërore	13
	2.4. Procedurat për t'iu përmbajtur rregullave të Ndhmës Shtetërore sipas TKE	14
3.	Vlerësimi i efektit të Ndhmës Shtetërore mbi objektivin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike	15
	3.1. Rasti i studimit – Kosovë (TC Kosova e Re)	18
	3.2. Rasti i studimit – Serbi (TC Kollubara B)	21
	3.3. Rasti i studimit – Bosnjë dhe Hercegovina (TC Tuzla 7)	23
	3.4. Rasti i studimit – Bullgari (TC Maritsa East 3)	24
	3.5. Rasti i studimit – Hungari	25
4.	Autoriteti i Ndhmës Shtetërore	26
5.	Konkluzione dhe rekomandime	27

Hyrje

Ky studim analizon pajtueshmërinë e rregullave të Bashkimit Evropian për Ndhmën Shtetërore me synimet e liberalizimit të tregut të energjisë në Ballkan. Bashkimi Evropian (BE) ka filluar shumë më parë procesin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike duke konsideruar se një treg i vetëm i energjisë elektrike do të sigurojë energji elektrike më të përballueshme për qytetarët e Evropës si dhe zhvillim të qëndrueshëm. Në pajtim me këtë, BE ka nisur një sërë reformash për të siguruar liberalizimin e tregut brenda Evropës. Disa prej reformave të tilla janë prishja e monopoleve në tregun e energjisë elektrike, privatizimi i entiteteve shtetërore dhe rritja e kapaciteteve të linjave ndërkufitare të interkoneksionit të energjisë elektrike.

Edhe pse shumë shtete të Evropës i kanë përfunduar pjesën më të madhe të reformave rregullative për të arritur deri tek një treg i hapur i energjisë elektrike, kërkimi i investimeve në linja të interkoneksionit të energjisë elektrike dhe në gjenerim të energjisë elektrike vazhdon të mbetet sfidues. Sa i përket të parës, në nëntor 2017, Komisioni i BE kishte propozuar që të gjitha shtetet e BE të arrijnë të mbulojnë me interkoneksione së paku 15 për qind të kapacitetit të instaluar të prodhimit të energjisë elektrike deri në vitin 2020.¹ Për të asistuar në arritjen e këtij synimi, Komisioni ka krijuar fonde të veçanta, siç është Instrumenti i Konektivitetit të Evropës (CEF), që planifikon investimin e 33 miliardë eurosh për ngritjen e infrastrukturës së energjisë dhe infrastrukturës digjitale mes viteve 2014 dhe 2020.² Specifikisht, 4.5 nga 5.85 miliardë euro të destinuara për projekte të energjisë do të ndahen në formë të granteve. Propozimi i ri i vitit 2018 ka paraparë ngritjen e këtij buxheti në 42.3 miliardë, nga të cilat 8.7 miliardë do t'i dedikohen sektorit të energjisë.

Sa i përket prodhimit të energjisë elektrike, direktiva e Komisionit Evropian obligon vendet që të garantojnë siguri të furnizimit të saj.³ Megjithatë, për disa prej tyre, në veçanti për ato të Ballkanit, garantimi i kësaj sigurie nënkupton ndërtimin e kapaciteteve të reja në vendet e tyre dhe/ose sigurimin e një burimi nga jashtë. Shtetet e Ballkanit shpesh thonë se projektet e energjisë janë të shtrenjta dhe qasja në financa përbën pengesë të theksuar, prandaj, joshja e investitorëve privatë në projekte të tilla vazhdon të mbetet sfida. Rrjedhimisht, shumë prej këtyre vendeve kanë joshur investitorë privatë në gjenerim të rrymës, duke u garantuar atyre një pjesë të tregut për një periudhë të caktuar kohore ose duke u garantuar kreditë. Kjo metodë e garantimit të shitjes shpesh njihen si Marrëveshje për Blerje të Energjisë (MBE), e në thelb nënkupton një mjet për mbylljen e tregut të energjisë elektrike për konkurrentët tjerë.

Investimet e kryera rishtas në termocentrale të vendeve të Ballkanit duket se janë në kundërshtim me ligjet e BE-së për konkurrencën dhe Ndhmën Shtetërore. Arritja e qëllimit të krijimit të tregut të përbashkët të energjisë elektrike është duke u rrezikuar nga përfshirja aktuale e Ndhmës Shtetërore në projekte të energjisë. Synimi i BE-së për të investuar në rrjete elektroenergjetike mund të rrezikohet dukshëm nga investimet e bëra nën MBE dhe instrumente tjera, të cilat i shkelin rregullat mbi Ndhmën Shtetërore. Në këtë frymë, qëllimi i këtij hulumtimi është që të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse të projekteve të termocentraleve me thengjill të cilat shkelin ligjet e BE-së mbi Ndhmën Shtetërore dhe ndikimin e

1 Komisioni Evropian. Caqet e Interkoneksionit të Energjisë Elektrike. Burimi: <https://bit.ly/2BbsGQp>

2 Komisioni Evropian. Instrumenti i Konektivitetit të Evropës (CEF). Burimi: <https://bit.ly/2ynXqgz>.

3 Direktiva 2005/89/EC — masat e sigurimit të furnizimit të energjisë elektrike dhe investimeve në infrastrukturë. Burimi: <https://bit.ly/2WXRDUH>

tyre në arritjen e cakut të liberalizimit të tregut. Përveç kësaj, konsumi i energjisë elektrike për kokë banori në shtetet e Ballkanit të cilat janë të pasura me burime të energjisë është dukshëm nën mesataren e BE-së. Si rezultat i kësaj, ato kanë potencial për të joshur investime pa rrezikuar funksionimin e tregut të lirë.

Analiza jonë preliminare e kësaj çështjeje, vlerësimet e Sekretariatit të KE, dhe kontratat e lidhura shpërfaqin se janë disa projekte që po zhvillohen në vende të ndryshme të Ballkanit mund të klasifikohen si projekte që shkelin ligjet e Ndhmës Shtetërore dhe rrezikojnë mbylljen e tregjeve. Ky punim do të shfrytëzojë rastet e studimit për të dëshmuar se si Ndhma Shtetërore po pengon arritjen e cakut të BE-së për të hapur tregun e energjisë elektrike në Ballkan. Disa prej rasteve të studimit që janë shqyrtuar janë: a) kontrata e nënshkruar rishtas mes Kosovës dhe ContourGlobal për ndërtimin e një Termocentrali (TC) prej 500MW; b) garancia kreditore e Serbisë për TC Kollubara; dhe c) plani i Bosnjës dhe Hercegovinës për të lejuar Ndhmë Shtetërore për ndërtimin e TC Tuzla 7.

Ky punim nxjerr edhe një sërë konkluzionesh lidhur me Ndhmën Shtetërore në shtetet e Ballkanit. Një konkluzion i rëndësishëm është që autoritetet e Ndhmës Shtetërore të Palëve Kontraktuese (PK) të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) kanë aftësi dhe/ose pavarësi të limituar për të vlerësuar masat e Ndhmës Shtetërore. Sekretariati i TKE ka fuqi ligjore të kufizuar dhe nuk po arrin që të parandalojë shkeljet e dispozitave të Ndhmës Shtetërore nga PK. Megjithatë, shtetet si Bullgaria dhe Hungaria, për shkak të reperkusioneve që i kanë vuajtur, mund të shërbejnë si shembull i pasojave që mund të pësohen nëse nuk veprohet në pajtim me ligjet e Ndhmës Shtetërore. Fundja, KP kanë kapacitet për të joshur investitorë në projekte në energji elektrike edhe pa ofruar përkrahje të Ndhmës Shtetërore, pasi që janë të pasura me resurse dhe kanë nivel të ulët të konsumit të energjisë elektrike në krahasim me vendet tjera të BE-së.

1. Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike në BE

BE është zotuar të liberalizojë dhe integrojë tregjet e brendshme të energjisë elektrike të shteteve anëtare aktuale dhe atyre që aspirojnë anëtarësimin në BE si pjesë e një caku më të madh që ishte krijimi i një tregu të vetëm të energjisë elektrike në BE. Veprimet specifike, të ndërmarra në formë të legjislacionit dhe investimeve, janë realizuar duke pasur në mendje këtë cak. Rregullat themelore të konkurrencës në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) thonë se asnjë akter në treg nuk mund të abuzojë me pozitë dominuese në tregun e brendshëm apo të pranojë trajtim favorizues (institucional). Në vitin 2009, në BE hyri në fuqi Pakoja e Tretë e Energjisë (PTE) me të cilën rregullohen tregjet e brendshme të energjisë. Direktiva relevante mbi energjinë elektrike ka për synim parimisht shthurjen e tregjeve të brendshme të energjisë elektrike, duke i ndarë operacionet e transmissioinit prej kompanive të gjenerimit dhe furnizimit.⁴ Subjektet e pavarura të transmissioinit pritet të rrisin konkurrencën duke aplikuar mekanizma adekuatë kontrolli dhe duke e hapur tregun për prurje të reja. Përveç kësaj, TPE mëton të shtojë bashkëpunimin ndërkufitar mes operatorëve të transmissioinit dhe pavarësinë e zyrave të rregullatorëve të energjisë. Bashkërisht, këto nisma do të shtojnë konkurrencën në tregjet e brendshme të energjisë elektrike të Shteteve Anëtare dhe rrjedhimisht të gjenerojnë masa stimuluese të barabarta për investitorë, të cilët planifikojnë të angazhohen në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike.

BE ka qenë e angazhuar në simulimin e nismave të tilla në pajtim me TPE dhe direktivat tjera, duke financuar dhe promovuar projektet relevante. Specifikisht, BE ka krijuar instrumentin financues CEF (Instrumenti i Konektivitetit të Evropës), i cili mes tjerash do të ofrojë financim për projekte të energjisë, për periudhën mes viteve 2014 dhe 2020. Mbi 4 miliardë nga 5.85 miliardë euro të ndara në këtë fond janë të dedikuara për projekte të energjisë dhe do jepen në formë grantesh.⁵ Aktualisht, në BE dhe pranë kufijve të saj janë duke u bërë disa investime në përmirësimin e konektivitetit të rrjeteve dhe shtimin e kapaciteteve të transmissioinit. Këto projekte vlerësohen për të garantuar siguri të furnizimit të energjisë, si rezultat i çmimeve më të ulëta për konsumatorët dhe industrinë. Plani i investimeve i Rrjetit Evropian i Operatorëve të Sistemeve të Transmissioinit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) paraqet dhjetëra projekte që po zhvillohen aktualisht në rrjete nëpër Evropë – shumë prej të cilave do të hyjnë në funksion para vitit 2030 (shih Figurën 1).⁶

4 Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 korrik 2009 mbi rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të energjisë elektrike. Burimi: <https://bit.ly/2EySpOL>

5 Komisioni Evropian. Instrumenti i Konektivitetit të Evropës. Burimi: <https://bit.ly/2aMgvJu>

6 ENTSO-E. Planet rajonale të investimeve. Burimi: <https://bit.ly/2QVpvVT>

Figura 1. Investimet aktuale dhe të planifikuara në Projekte të Interkoneksioneve nëpër Evropë

- Increases already identified in TYNDP 2016
- - - Increases beyond 2030 in only one scenario
- Increases beyond 2030 in at least 2 scenarios



- CSW** - Continental South West
- CCS** - Continental Central South
- CSE** - Continental South East
- CCE** - Continental Central East
- BS** - Baltic Sea
- NS** - North Sea


Burimi: ENTSOE⁷

Për më tepër, në vitin 2014, BE ka iniciuar Agjendën e saj të Konektivitetit, që ka për qëllim rritjen e kapaciteteve të koneksionit mes shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe rrjedhimisht krijimin e një tregu rajonal të energjisë elektrike. Në takimet e përbashkëta dhe samitet që u zhvilluan nga viti 2015, janë iniciuar disa projekte për të cilat zotime financiare janë bërë nga BE dhe shtetet e ndryshme. Specifikisht, në periudhën 2015-2017, grante të BE-së janë ndarë për katër projekte prioritare – të cilat janë më të pakta në numër se sa projektet e interkoneksionit, në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi, me vlerë prej 108.4 milionë euro, apo 30 për qind të vlerës së gjithmbarshme të investimeve (shih Figurën 2).⁸

⁷ Po aty

⁸ Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF). Bashkëfinansim i projekteve investuese në Ballkanin Perëndimor në periudhën 2015-2017. Burimi: <https://bit.ly/2BpQbM9>

Figura 2. Investimet kryesore në infrastrukturën energjetike në Ballkanin Perëndimor 2015-2017



Burimi: Korniza e Investimeve në Ballkanin Perëndimor


Një linjë e tillë e interkoneksionit është realizuar mes Kosovës dhe Shqipërisë, me kosto prej 70 milionë euro, e iniciuar para përzgjedhjes së këtyre katër investimeve prioritare në Ballkanin Perëndimor dhe e përfunduar në vitin 2016.⁹

Sipas raporteve vlerësuese të ENTSO-E, rritja e kapaciteteve të gjenerimit të energjisë në Evropë do të ketë ndikim pozitiv në mirëqenien e shoqërisë së BE-së. Por, skenarët dëshmojnë se ndikimi varet nga fakti nëse kapacitetet e porsandërtuara të gjenerimit të energjisë do të përcillen me investime edhe në linja të interkoneksionit. Nëse realizohen investime adekuate në të dyja këto fusha, ndikimi i zvogëlimit të koston margjinale të energjisë elektrike do të jetë i dukshëm. Sipas ENTSO-E, rritja e kapaciteteve të gjenerimit të energjisë elektrike që pritet të realizohet anembanë Evropës në një të ardhme të afërt pritet të rezultojë me zbritje të koston margjinale të prodhimit të energjisë mes 7 €/MWh dhe 10 €/MWh. Megjithatë, nëse investimet në fjalë përcillen me investime në avancimin e infrastrukturës të interkoneksionit, e cila duhet të mundësojë këmbimin më të shpejtë të energjisë elektrike, planifikimin më të mirë dhe bashkëpunimin më të mirë mes vendeve – ndikimi në zbritjen e koston margjinale të prodhimit të energjisë elektrike do të jetë më i madh. Në këtë rast, kostoja margjinale do të zbritej mesatarisht mes 18 dhe 33€/MWh (Figura 3).¹⁰ Prandaj, BE ka përkrahur të gjitha iniciativat strategjike për shtimin e kapaciteteve të transmisionit.

⁹ SeeNews. Linja 400kV Shqipëri-Kosovë hyn në funksion. Burimi: <https://bit.ly/2SRGiKs>

¹⁰ ENTSO-E. Planet rajonale të investimeve. Burimi: <https://bit.ly/2QVpvVT>

Figura 3. Ndikimi i kapaciteteve të reja të gjenerimit dhe linjave të interkoneksionit në zbritjen e kostos marginale të prodhimit të energjisë në Evropë



◆ No Grid scenario ◆ 2040 scenarios with scenario grid

Burimi: ENTSOE¹¹

2. Rregullat e Ndihmës Shtetërore

2.1. Ndihma Shtetërore sipas BE dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë

Regjimi i Ndihmës Shtetërore kryesisht definohet në nenet 107-109 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Gjykata e Drejtësisë e BE-së (GJDBE) ofron interpretime tjera në praktikën e vet gjyqësore lidhur me rregullat në fjalë. Neni 107 i TFBE definon Ndihmën Shtetërore si “[...] ndihmë e dhënë nga një Shtet Anëtar apo përmes resurseve shtetërore në çfarëdo forme të mundshme, e cila shtrembëron apo kërcënon konkurrencën, duke favorizuar sipërmarrje të caktuara apo prodhimin e mallrave të caktuara në rast se kjo ndikon në tregtinë mes Shteteve Anëtare apo nuk është në përputhje me tregun e brendshëm.¹²” Me fjalë tjera, nëse një subjekt pranon asistencë nga qeveria, dhe si rezultat favorizohet në krahasim me konkurrencën e vet, kjo konsiderohet si antikonkurrese dhe kualifikohet si Ndihmë Shtetërore.

Komisioni Evropian është përgjegjës për tu siguruar se të gjitha masat e ndërmarra nga Shtetet Anëtare janë në pajtim me ligjet e Ndihmës Shtetërore.¹³ Komisioni përmes dispozitave të këtyre ligjeve ka autoritet diskrecional për të rishikuar veprimet e shteteve dhe përcaktuar nëse një masë e caktuar kualifikohet si ndihmë e lejueshme. Si test preliminar për të përcaktuar nëse një masë shtetërore kualifikohet si ndihmë e palejuar, i rrënjësuar në praktikën gjyqësore, Komisioni apo Gjykata e BE-së duhet të vlerësojnë komponentët në vijim:

Shteti duhet t’i japë avantazh ekonomik një sipërmarrjeje,¹⁴ apo një subjekti, të cilin i njëjti nuk do ta kishte në kushte normale të tregut. Përveç kësaj, avantazhi duhet të jetë selektiv për një sipërmarrje apo prodhim të caktuar dhe jo i zbatueshëm për ekonominë në përgjithësi.

Avantazhi ekonomik i pranuar nga subjekti duhet të vjen nga shteti përmes resurseve publike.¹⁵ Koncepti i resurseve shtetërore përbëhet nga një gamë e gjerë e metodave, përfshirë pushimet tatimore, subvencionet, grantet, shitja e tokës publike, huazimet e veçanta, garancitë, marrëveshjet afatgjata të blerjes, etj. Një definicion më i thuktë i resurseve shtetërore përkufizohet në praktikën gjyqësore.

Masa e ndërmarrë nga shteti ka gjasa të pengojë konkurrencën mes Shteteve Anëtare. Gjatë hetimit, Komisioni apo GJDBE nuk duhet të dëshmojnë se një masë e caktuar do të pengojë konkurrencën; në fakt ato duhet të dëshmojnë vetëm se masa ka gjasa të prodhojë rezultat të tillë.

Shtetet tradicionalisht kanë pasur në pronësi dhe kanë investuar në shumë kompani që gjenerojnë dhe bartin energjinë. Megjithatë, këto rregulla nuk ua ndalojnë shteteve të investojnë në ndërmarrje shtetërore përderisa investimet të realizohen në mënyrë të ngjashme siç do të investonte një investitor privat në

¹² Neni 107 (1) i TFBE. Burimi: <https://bit.ly/2QQbso3>

¹³ Bashkimi Evropian. Konkurrenca dhe Ndihma Shtetërore dhe kontrollimi i tyre. Burimi: <https://bit.ly/1mqMY-pA>

¹⁴ Jurisprudenca përkufizon sipërmarrjen si subjekt i angazhuar në një aktivitet ekonomik, pa marrë parasysh statusin ligjor dhe mënyrën e financimit të tyre. Faqe 4. Burimi: <https://bit.ly/2QFnbwR>

¹⁵ Koncepti i resurseve publike apo shtetërore ngërthen të gjitha nivelet e administratës së shtetit, përfshirë qeveritë lokale e qendrore dhe çdo autoritet publik.

një kompani private.¹⁶ Nëse ndërmarrja publike shfrytëzon resurse të autoriteteve publike për të realizuar një politikë të caktuar publike, atëherë masat mund të konsiderohen Ndhimë Shtetërore¹⁷.

Rregullat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) mbi atë se çfarë përbën Ndhimë Shtetërore nuk dallojnë nga këto. Komuniteti i Energjisë është një organizatë ndërkombëtare e themeluar nga BE dhe shtetet tjera jashtë BE-së në Evropë, për të zgjeruar shtrirjen e legjislacionit të BE-së nga fusha e energjisë, konkurrencës dhe mjedisit tek anëtarët e TKE-së.¹⁸ Me nënshkrimin e traktatit, anëtarët e TKE janë pajtuar të fillojnë me transpozimin e legjislacionit të BE-së mbi energjinë elektrike, konkurrencën dhe mjedisin në legjislacionet e tyre. Sa i përket Ndhimës Shtetërore, neni 18 i TKE drejtpërsëdrejti korrespondon me nenin 107 të TFBE, dhe kërkon nga anëtarët e TKE të ndalojnë Ndhimën Shtetërore e cila dëmton konkurrencën dhe ndikon në tregtimin e energjisë mes Palëve Kontraktuese.¹⁹ Ky traktat është ligjërish i obligueshëm për PK.

Përveç traktatit, shtetet jashtë BE-së në Ballkan kanë lidhur Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit (MSA), të cilat kryesisht ua ndalojnë shteteve dhënien e Ndhimës Shtetërore si pjesë e obligimit të tyre për të implementuar legjislacionin e BE-së. Komisioni kryen analizën e shkeljeve potenciale të legjislacionit të BE-së mbi konkurrencën dhe Ndhimën Shtetërore gjatë procesit të negociimit të anëtarësimit në BE.²⁰

Përkrah obligimeve ndërkombëtare, Palët Kontraktuese të TKE kanë miratuar Ligjin për Ndhimën Shtetërore (LNSH) dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës (LMK).²¹ Ato gjithashtu kanë nominuar autoritetet institucionale për zbatimin e ligjeve të konkurrencës.

Prandaj, pa marrë parasysh nëse një shtet është anëtar i BE-së, të gjitha shtetet e Evropës u nënshtrohen ligjeve që ndalojnë Ndhimën Shtetërore dhe mbrojnë konkurrencën në Evropë. Edhe BE edhe TKE i bëjnë referencë legjislacionit evropian nga fusha e Ndhimës Shtetërore dhe përkufizimit të saj. Megjithatë, nga këndvështrimi procedural, ka dallim mes Shteteve Anëtare të BE-së dhe KP të TKE, i cili do të sqarohet në nenin 2.4 më poshtë.

Qëllimi i ligjeve të konkurrencës është që të sigurojë kushte të barabarta për të gjitha vendet, dhe të shmangë garimin në ndarje të subvencioneve, gjë që rezulton me çuarje dëm të resurseve publike. Prandaj, nëse janë të pranishme të gjitha kriteret e lartpërmendura, shteti i caktuar është në shkelje të ligjeve të BE-së mbi Ndhimën Shtetërore, përveç nëse kemi të bëjmë me instanca kur Ndhima Shtetërore konsiderohet e lejueshme.

¹⁶ Neni 345 i TFBE thotë se Traktati nuk i paragjykon në asnjë mënyrë rregullat e Shteteve Anëtare që rregullojnë sistemin e pronësisë. Burimi: <https://bit.ly/2OHGooT>

¹⁷ Po aty

¹⁸ BE – Traktati i Komunitetit të Energjisë. Burimi: <https://bit.ly/2SzjY3S>

¹⁹ Rregullat e Ndhimës Shtetërore dhe Efektivitetit të Kontrollit të Ndhimës Shtetërore në Sektorin e Energjisë Elektrike sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Faqe 9. Burimi: <https://bit.ly/2QD8Nv2>

²⁰ Politika Evropiane e Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerim. Kapitulli 8. Burimi: <https://bit.ly/2tg95ci>

²¹ Rregullat e Ndhimës Shtetërore dhe Efektivitetit të Kontrollit të Ndhimës Shtetërore në Sektorin e Energjisë Elektrike sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Burimi: <https://bit.ly/2QD8Nv2>

2.2. Ndhimja Shtetërore

Përkundër aspekteve negative, Ndhimja Shtetërore mund të sjell edhe përfitime. Ajo mund t'u ndihmojë shteteve në sigurimin e një objektivi politik që është i dëshirueshëm për shoqërinë, ndërsa minimizon efektin në konkurrencë. Neni 107 i Traktatit i lejon Komisionit klasifikimin e ndihmës së lejuar shtetërore.²² Komisioni ka për detyrë të hetojë masat kombëtare dhe të vlerësojë nëse masat janë në pajtim me objektivat energjetike të BE-së apo përjashtohen nga obligimet e ndryshme. Për tu klasifikuar si masë e lejuar e ndihmës shtetërore, duhet të plotësohet së paku një nga kriteret në vijim:

Ndhimja shtetërore e ndarë me karakter social apo për të lehtësuar efektet e katastrofave natyrore konsiderohet detyruesisht e përjashtuar.²³ Për shembull, sigurimi i qasjes në energji elektrike konsiderohet e mirë e domosdoshme; prandaj, shtetet kanë dizajnuar politika sociale për ata që nuk mund ta përballojnë koston e energjisë elektrike. Në këtë drejtim, ndihma është e lejueshme nëse qeveria i jep konsumatorëve vauçer për blerje të energjisë elektrike pa indikacion se ku duhet blerë ajo. Komisioni duhet të njoftohet se si politika sociale apo intervenimi në rast të katastrofës natyrore në fakt nuk përbëjnë avantazh për një sipërmarrje specifike.

Përjashtime diskrecionale janë ato që Komisioni i konsideron të jenë në pajtim me ligjet e BE-së dhe objektivat e saj.²⁴ Do të thotë vlerësimi bëhet nëse ndihma është dhënë për të përkrahur zhvillimin ekonomik në zona me standard të ulët të jetesës dhe papunësi të theksuar. Rast tjetër është kur ndihma jepet për të përkrahur ruajtjen e trashëgimisë kulturore pa ndikuar në tregti. Jo sikur në rastin e përjashtimeve të detyrueshme, përjashtimet diskrecionale duhet të shqyrtohen nga Komisioni para së të klasifikohen si të lejueshme. Duke qenë se fushëveprimi i gjithmbarshëm i këtyre përjashtimeve është shumë i zbehtë, Komisioni ka miratuar udhërrëfyes për Shtetet Anëtare në vlerësimin e ndihmës së lejueshme sipas përjashtimeve të nenit 107 (3). Udhërrëfyesi i ri i miratuar në vitin 2014 emërtohet Udhërrëfyesi për Ndhimë në Energji dhe Mjedis 2014–2020 (EEAG).²⁵

Përjashtime tjera rrjedhin nga neni 106 (2) i TFBE dhe njihen si Shërbime me Interes të Përgjithshëm Ekonomik (SHIPE).²⁶ Ky nen lejon Ndhimën Shtetërore në rrethana të pazakonta kur ofruesi i energjisë duhet ta sigurojë energjinë me çmime të përballueshme dhe si rezultat përballat me humbje. Shteti në raste të tilla duhet t'ia kompensojë atij humbjet. Këto veprime të rralla janë të lejueshme, duke qenë se energjia konsiderohet domosdoshmëri dhe rrjedhimisht kualifikohet si shërbim në interes të përgjithshëm ekonomik. Në raste të tilla, shteti nuk i jep përparësi një sipërmarrjeje të caktuar por e kompenson atë për humbjet e paevitueshme të pësuar.

Rregulloret e Përjashtimit të Përgjithshëm në Bllok (GBER) përbëjnë kornizën rregullative që u mundëson shteteve të iniciojnë projekte pa u konsultuar me Komisionin.²⁷ Ky nen specifikon kushtet në të cilat Ndhimja Shtetërore konsiderohet automatikisht ndihmë e lejuar dhe nuk i nënshtrohet kërkesës për ta njoftuar Komisionin për ndërmarrjen e saj. Sipas kornizës së GBER, Komisioni lejon ndihmë në fushat si portet, aeroportet, kultura dhe fusha sportive multifunkionale. Vlera e ndihmës që bie nën kriteret e GBER përbën rreth 95 për qind të tërë ndihmës së

²² Neni 107 (2) i TFBE. Burimi: <https://bit.ly/zQQbso3>

²³ Po aty

²⁴ Po aty

²⁵ Udhërrëfyesi për Ndhimën Shtetërore për mbrojtje të mjedisit dhe energji 2014–2020. Burimi: <https://bit.ly/2DvGVcb>

²⁶ Neni 106 (2) i TFBE. Burimi: <https://bit.ly/2OBXKfM>

²⁷ Neni 109 – Rregulloret për Përjashtimet në Bllok. Burimi: <https://bit.ly/2pTpRLU>

dhënë.²⁸ Kjo zbutë barrën e Komisionit dhe u mundëson atyre të fokusohen në projekte që kanë më shumë potencial për të dëmtuar konkurrencën në Shtetet Anëtare. GBER është më e aplikueshme për Shtetet Anëtare të BE-së dhe nuk mund të replikohet në të gjitha PK të TKE.

Rregullorja për Ndhimë Shtetërore De Minimis u lejon Shteteve Anëtare të japin ndihmë që nuk tejkalon shumën prej 200,000 euro përgjatë një periudhe trevjeçare.²⁹ Këtë veprim Komisioni e konsideron të lejueshëm pasi që vlera e ndihmës së ofruar nga shteti ka pak mundësi të shkaktojë pengesa në treg. Ngjashëm me GBER, ndihma de minimis aplikohet më shumë për shtetet e BE-së dhe jo për të gjitha PK të TKE.

Kriteret e listuara janë vetëm disa prej mënyrave në të cilat ndihma mund të konsiderohet e pranueshme. Megjithatë, kurdo ndihma ka potencial për të ndikuar negativisht mbi tregtinë brenda Shteteve Anëtare, Komisioni do të vendosë kundër veprimeve të tilla, për ta mbrojtur konkurrencën.

2.3. Pasojat juridike të mospajtueshmërisë me rregullat e BE-së dhe TKE-së për Ndhimën Shtetërore

2.3.1. Mospajtueshmëria me rregullat e BE-së për Ndhimën Shtetërore

Edhe pse Ndhimë Shtetërore në Evropë është e ndaluar, pasojat e mospajtueshmërisë dallojnë varësisht prej asaj a është shteti i caktuar pjesë e BE-së apo e TKE-së. Shtetet Anëtare të BE-së janë përgjegjëse për ta njoftuar Komisionin para ndërmarrjes së ndonjë mase që mund të konsiderohet Ndhimë Shtetërore, përveç në rastet kur bie nën fushëveprimin e rregulloreve të GBER apo ndihmës de minimis.³⁰ Nëse Komisioni arrin tek përfundimi se ndihma nuk është në pajtim me nenin 107, shteti udhëzohet që të shfuqizojë apo modifikojë masën brenda një periudhe të caktuar nga Komisioni. Nëse shteti refuzon t'i përmbahet vendimit të Komisionit, Komisioni apo shtetet tjera të interesuara të BE-së mund ta ndjekin rastin para GJDBE.³¹

Përveç GJDBE, konkurrentët e përfituesit e ndihmës shtetërore mund t'u referohen edhe gjykatave nacionale. Më pas, gjykata mund ta pezullojë masën apo udhëzojë pranuesin që ta rimbursojë ndihmën e pranuar (kthimi i ndihmës).³² Gjykatat nacionale po ashtu mund të urdhërojnë anulimin e kontratës nëse masa nuk autorizohet nga Komisioni dhe përbën ndihmë shtetërore të paligjshme.

2.3.2. Mospajtueshmëria me rregullat e TKE për Ndhimën Shtetërore

Siç u përmend më parë, një dallim i madh mes rregullave të TKE dhe BE mbi Ndhimën Shtetërore është ai në procedurat e njoftimit. TKE nuk parasheh formimin e ndonjë institucioni përgjegjës për pranimin e njoftimeve për ndihmat. Rregullat e TKE i bëjnë referencë rregullave të Ndhimës Shtetërore përveç nenit 108 të TFBE i cili rregullon procedurat mbi njoftimin e ndihmës. Rrjedhimisht, PK të TKE nuk janë të obliguara ta njoftojnë Sekretariatit e TKE para implementimit të ndonjë ndihme.

Madje edhe nëse Sekretariati i TKE nxjerr vendim të obligueshëm ligjërish që një anëtar i TKE i ka shkelur rregullat mbi Ndhimën Shtetërore, ai ka autoritet të kufizuar për të parandaluar këtë masë. Nenet 90-92 të TKE mbi Implementimin e Vendimeve

²⁸ Rregullorja për Përfundimet e Përgjithshme në Blllok. Burimi: <https://bit.ly/2B1cnp7>

²⁹ Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1998/2006. Burimi: <https://bit.ly/2z4Eti4>

³⁰ Ndryshimi i vitit 2013 i Rregullores Procedurale për Ndhimë Shtetërore. Burimi: <https://bit.ly/2S1jBQ1>

³¹ Neni 108 – Ndhimë dhe dhënë nga Shtetet. Burimi: <https://bit.ly/2T3m4uo>

³² Bashkimi Evropian. Konkurrenca dhe Ndhimë Shtetërore dhe kontrollimi i tyre. Burimi: <https://bit.ly/2Lkimch>

dhe Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve thonë se “dështimi nga një Palë për të vepruar në pajtueshmëri me Traktatin apo për të implementuar ndonjë vendim [...] mund të sillt për shqyrtim para Këshillit të Ministrave.”³³ Këshilli i Ministrave me shumicë të thjeshtë votash mund të vendosë nëse një PK i ka shkelur rregullat e TKE, ndërsa vendimi për të arritur tek konkludimi për një “shkelje të rëndë” të TKE duhet të merret me vendim unanim të Këshillit të Ministrave. Në rast se vërtetohet ndonjë shkelje e rëndë, të drejtat e shtetit në votim mund të pezullohen dhe i njëjti mund të përjashtohet nga takimet.³⁴ Marrë parasysh kufizimet e TKE, Sekretariati ka vështirësi në parandalimin e masave të Ndhmës Shtetërore të palejuar.

Megjithatë, ndihma e palejuar mund të adresohet edhe në nivel shteti duke i shfrytëzuar gjykatat nacionale. Pasi që PK të TKE kanë miratuar ligje mbi konkurrencën dhe Ndhmën Shtetërore, konkurrentët e përfituesve të ndihmës mund t'i trajtojnë rastet pranë gjykatave nacionale. Varësisht nga ligjet e vendit. Gjyqtarët mund të urdhërojnë autoritetin publik përgjegjës për ofrimin e grantit që t'ia paguajë dëmet konkurrentit apo edhe t'i anulojë kontratat për ta rikthyer konkurrentin në tregun e brendshëm.

Shkelja e rregullave të Ndhmës Shtetërore nga një shtet i Ballkanit që nuk është anëtar i BE-së mund ta komplikojë procesin e negocimit të anëtarësimit në BE për to. Sipas të drejtës ndërkombëtare, palët nënshkruese të MSA kanë për detyrë implementimin e legjislacionit të BE-së mbi Ndhmën Shtetërore. Dështimi i një shteti për t'iu përmbajtur këtij obligimi i jep Komisionit autoritetin për të shpallur shkeljen e MSA-së dhe për të marrë vendimin për t'i ndërprerë negociatat e anëtarësimit në BE.³⁵

Përfundimisht, qoftë nëse një shtet është pjesë e BE-së apo TKE-së, shkelja e ligjeve mbi të Ndhmën Shtetërore mund t'i dërgojë sinjale destruktive ekonomisë së vendit. Shtetet që angazhohen në kontrata afatgjata që shkelin ligjet e konkurrencës duhet të kenë edhe ndëshkime për mosimplementimin e projektit të paraparë fillimisht në kontratë. Kjo krijon pasiguri në politika publike.

2.4. Procedurat për t'iu përmbajtur rregullave të Ndhmës Shtetërore sipas TKE

Përveç të drejtës ndërkombëtare, Palët Kontraktuese të TKE kanë miratuar ligje nacionale për Ndhmën Shtetërore. Në përgjithësi këto ligje obligojnë formimin e një departamenti përgjegjës për Ndhmë Shtetërore dhe ofrimin të përkrahjes profesionale dhe administrative për komisionin nacional të Ndhmës Shtetërore. Komisioni nacional është autoritet nacional vendimmarrës për ndihmën në nivel nacional. Ligjet shtetërore kërkojnë që shteti ta njoftojë autoritetin kombëtar për dhënien e ndihmës para implementimit të saj. Dështimi për ta njoftuar autoritetin për ndihmën bën që ndihma të jetë joligjore dhe mund të rezultojë me detyrim të kthimit të ndihmës.

Nëse ndihma i bëhet e ditur autoritetit shtetëror të Ndhmës Shtetërore, i njëjti duhet ta shqyrtojë njoftimin dhe të vlerësojë nëse masat janë në pajtim me ligjin nacional të Ndhmës Shtetërore. Një vegël e dobishme gjatë vlerësimit fillestar është udhërrëfyshi i EEAG.³⁶ Ky udhërrëfyes pasqyron qëndrimin e Komisionit të BE lidhur me skemat e ndryshme të mbështetjes dhe pajtueshmërisë së tyre me ligjet

³³ Kapitulli V – Aktet procedurale. Neni 90. Burimi: <https://bit.ly/2DCozNc>

³⁴ Po aty.

³⁵ Përgjigja në Kërkesën e Arsyetuar në rastin ECS-11/14. Faqe 5. Paragrafi 22. Burimi: <https://bit.ly/2Eyzv1n>

³⁶ Udhërrëfyshi për Ndhmën Shtetërore për Mbrojtje të Mjedisit dhe Energji 2014-2020. Burimi: <https://bit.ly/2DvGVcb>

e BE-së mbi konkurrencën. Nëse masa nuk mund të analizohet si duhet, autoriteti i Ndhmës Shtetërore mund të kërkojë me shkrim asistencë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë apo ndonjë organizatë tjetër me ekspertizë në fushën e Ndhmës Shtetërore.³⁷

Nëse departamenti ose komisioni kombëtar nuk e vlerëson apo e vlerëson gabimisht masën e Ndhmës Shtetërore, atëherë Sekretariati do t'ia dërgojë njoftim (opinion) lidhur me lejueshmërinë e ndihmës sipas rregullave të TKE-së. Departamenti kombëtar duhet të implementojë vlerësimin e Sekretariatit për të shmangur mundësinë e hapjes së procedurës kontestimore apo procedurave tjera gjyqësore në nivel nacional.

3. Vlerësimi i efektit të Ndhmës Shtetërore mbi objektivin e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike

BE i ka vënë vetes moti për qëllim krijimin e një tregu të vetëm të energjisë elektrike në Evropë. Arritja e këtij objekti, përveç reformave të liberalizimit të tregut, kërkon edhe investime në rrjetet elektroenergetike. Linjat më efikase të interkoneksionit u ofrojnë shteteve tregtimin e lirshëm të energjisë elektrike, ndërsa eliminojnë apo zvogëlojnë mungesat e energjisë. Si rezultat i kësaj, BE ka krijuar fonde të ndryshme, siç është Instrumenti i Konektivitetit të Evropës (CEF), i cili i ndan 33 miliardë euro për zhvillimin e infrastrukturës së transportit dhe infrastrukturës digjitale, mes viteve 2014 dhe 2020.³⁸ Komisioni i BE-së krijon një listë të projekteve të BE-së, me interes të përbashkët, të cilët mund të kualifikohen për financim nga CEF. Në vitin 2018, u paraqit një propozim i ri për ta rritur buxhetin e CEF në 42.3 miliardë euro, nga të cilat 8.7 miliardë janë të alokuara për energji. Megjithatë, përkundër investimeve në rrjete të energjisë elektrike, ky punim argumenton se nëse BE nuk siguron parandalimin e dhënies së Ndhmës Shtetërore për projekte në energji elektrike, investimet në rrjetet e energjisë elektrike do të jenë të padobishme në kuptim të arritjes së rezultateve të synuara.

Shtetet e Ballkanit janë duke u thirrur në direktivën për sigurinë e furnizimit të energjisë elektrike në vendimet e tyre për të ndërtuar kapacitete të reja.³⁹ Duhet të argumentohet se joshja e investimeve të reja në energji elektrike përbën sfidë, e kësaj duhet të ofrohen garanci të shitjes për investimet apo përkrahje shtetërore e tjetër lloji. Figura 4 paraqet planet për zhvillimin e kapaciteteve elektroenergetike nga thëngjilli në vitin 2012 dhe 2020.⁴⁰


37 Ligji i Kosovës për Ndhmën Shtetërore, neni 13 (3). Burimi: <https://bit.ly/2N5s6b6>
Ligji i Serbisë për Ndhmën Shtetërore, neni 10 (5). Burimi: <https://bit.ly/2DCpGfP>

38 Komisioni Evropian. Instrumenti i Konektivitetit të Evropës (CEF). Burimi: <https://bit.ly/2ynXqgz>

39 Direktiva 2005/89/EC — masat për mbrojtjen e sigurisë së furnizimit të energjisë elektrike dhe investimeve në infrastrukturë. Burimi: <https://bit.ly/2WXRDUH>

40 Bankwatch Network. Thëngjilli në Ballkan. Burimi: <http://bit.ly/2FGsxsm>


Figura 4. Planifikimi i kapaciteteve elektroenergetike nga thëngjilli në Ballkan 2012 - 2020



Burimi: Bankwatch Network

Megjithatë, shtetet e Ballkanit posedojnë resurse të mjaftueshme për të përkrahur jo vetëm termocentrale të reja me thëngjill, por edhe kapacitete të energjisë së ripërtëritshme. Organizatat Ndërkombëtare Financiare, si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Botërore (BB), kanë refuzuar përkrahjen e termocentraleve me thëngjill për shkak se kanë grumbulluar fakte të mjaftueshme për të vërtetuar se Ballkani ka potencial të mjaftueshëm për të ndërtuar kapacitete të ripërtëritshme. Përveç disponueshmërisë së resurseve, investorët mund të prodhojnë energji elektrike në një rajon që nuk është duke konsumuar shumë për shkak të mosdisponueshmërisë së energjisë elektrike. Figura 5 në vijim paraqet se konsumi për kokë banori në shtetet e Ballkanit është mjaft më i ulët se sa konsumi mesatar për kokë banori në BE.⁴¹

41 Banka Botërore. Konsumi i energjisë elektrike (kWh për kokë banori). Burimi: <http://bit.ly/2PHze1W>

Figura 5. Konsumi i Energjisë Elektrike (kWh) për kokë banori në vitin 2014

Burimi: Banka Botërore

Përveç disponueshmërisë së burimeve natyrore dhe potencialit për rritje të konsumit të energjisë elektrike, shtetet e Ballkanit kanë interkoneksione të mira, pjesërisht për shkak të granteve të BE-së. Prandaj, joshja e investimeve në tregun e energjisë elektrike nuk ka nevojë të bëhet me Ndihmë Shtetërore.

Rastet e studimit në vijim paraqesin masën deri në të cilën shtetet e Ballkanit kanë qenë të përfshira në shkelje të dispozitave të Ndihmës Shtetërore. Përzgjedhja e rasteve është bërë në bazë të informatave të grumbulluara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

3.1. Rasti i studimit – Kosovë (TC Kosova e Re)

Një shembull ku Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE) bashkë me institucionet e BE-së nuk kanë arritur të jenë efektiv në parandalimin e një projekti të Ndihmës Shtetërore është ai i Kosovës. Të dyja institucionet janë përpjekur me vite të tëra që ta promovojnë procesin e liberalizimit elektroenergjetik në Kosovë. Në maj të vitit 2017, Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë kompletoi dhe miratoi tërë kornizën rregullative e cila është në pajtim me kërkesat e Pakos së Tretë të Energjisë të BE-së. Përveç miratimit të reformave politike, qeveria gjermane ofroi grant për përkrahjen e lidhjes së interkoneksionit mes Kosovës dhe Shqipërisë, në vlerë prej 16.5 milionë euro. Kjo përpjekje u bë për ta integruar tregun e energjisë elektrike të Kosovës në tregun unik evropian.

Megjithatë, në vitin 2017, qeveria e Kosovës ka nënshkruar Marrëveshje për Blerje të Energjisë (MBE) me ContourGlobal (GenCo) për ndërtimin e termocentralit Kosova e Re me kapacitet neto prej 450MW. Në këtë MBE, qeveria morri përsipër obligimin për të paguar ngarkesën për kapacitet dhe blerë energjinë elektrike të gjeneruar për një periudhë 20-vjeçare. Marrëveshja thotë se çmimi i synuar prej 80€/MWh do të garantohet për tërë këtë periudhë. Pas hyrjes në funksion, Kosova e Re do të jetë termocentrali më i madh në Kosovë; i dyti është Kosova B, ndërmarrje shtetërore e ndërtuar në vitet e 80-ta me kapacitet neto prej 300MW. Në bazë të MBE-së, qeveria do të krijojë një institucion (NKEC) për të vepruar si ndërmjetës mes Kosovës, GenCo-s dhe kompanive të distribucionit në Kosovë. NKEC do të obligohet t'i paguajë GenCo-s energjinë elektrike nën një çmim të garantuar, që përfshin një pagesë të lartë për kapacitet. Kjo MBE parashihet të veprojë si destimulues për investitorë që duan të hyjnë në tregun e energjisë elektrike në Kosovë për një periudhë 20-vjeçare.⁴² Ajo nuk i lejon NKEC dhe kompanive të furnizimit të energjisë të blejnë energji elektrike në çmime potencialisht më të ulëta në tregje të hapura në Kosovë dhe në rajon.

Ndërtimi i termocentralit Kosova e Re do ta bllokojë energjinë elektrike të Kosovës nga tregu evropian. Kosova do të jetë e obliguar me kontratë për të blerë energjinë elektrike nga termocentrali i ri me thëngjill edhe nëse çmimi i tregtimit të saj është më e ulët se sa ajo në tregun ndërkombëtar. Bazuar në projektimet e Sekretariatit, çmimi mestar i energjisë elektrike në rajon në vitin 2023 do të jetë rreth 50-60€/MWh ose për 20-30€/MWh më pak se sa çmimi i cili do t'i paguhet GenCos përgjatë periudhës 20-vjeçare. Termocentrali i ri në Kosovë do të bëjë që linjat e interkoneksionit të jenë joefektive, duke qenë se Kosova nuk do të hyjë në tregti me shtetet tjera evropiane.

Përkundër efektit dëmtues mbi konkurrencën, TC Kosova e Re shkel të drejtën kombëtare dhe ndërkombëtare. Sipas vlerësimit preliminar të Sekretariatit të TKE, TC Kosova e Re është në kundërshtim me ligjet evropiane mbi konkurrencën dhe Ndihmën Shtetërore.⁴³ Qeveria e Kosovës ka lidhur një kontratë me një subjekt i cili do të ndërtojë termocentralin e ri pa kërkuar miratimin e departamentit për ndihmë shtetërore, siç kërkohet me ligj. Ligji i Kosovës për Ndihmën Shtetërore e autorizon departamentin me të njëjtin emër që të monitorojë dhe vlerësojë projektet individuale dhe të vlerësojë nëse janë në pajtim me obligimet nacionale dhe ndërkombëtare. Në rast se departamenti nuk është në gjendje të kryejë vlerësimin, në pajtim me nenin 13(3) të Ligjit të Kosovës për Ndihmë Shtetërore, i

⁴² Kopac: Qytetarët do të paguajnë koston e lartë të ndërtimit të Kosovës së Re. Intervistë: Burimi: Koha Ditore. 13 shkurt 2019.

⁴³ Traktati i Komunitetit të Energjisë. Vlerësimi preliminar i TC Kosova e Re. Letra e dërguar nga TKE tek Ministri i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, z. Valdrin Lluka.

njëti mund të kërkojë asistencë nga Sekretariati.⁴⁴ Për më tepër, në vendimin e vet përfundimtar, Komisioni nacional duhet të merr parasysh vlerësimin e Sekretariatit.

⁴⁵Megjithatë, autoritetet e Kosovës nuk kanë kërkuar asistencë para nënshkrimit të kontratës.

Nga tetori i vitit 2015, Kosova është palë nënshkruese e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Neni 77(c) i kësaj marrëveshjeje, ngjashëm me ligjet e BE-së, ndalon angazhimin e përkrahjes së shtetit për subjekte në rast se mund të ndikojë konkurrencën.⁴⁶ Dështimi për t'iu përmbajtur kësaj marrëveshjeje mund të ndërpresë negociimin për hyrje në BE.

Aktualisht, ContourGlobal (GenCo) është në fazën përfundimtare të sigurimit të një kredie për të financuar projektin TC Kosova e Re. Pas finalizimit të kredisë, garancia e kredisë duhet të shkojë në parlamentin e Kosovës për miratim. Qeveria e Kosovës i ka dhënë përkrahje të plotë projektit, ndërsa nuk është e qartë nëse e njëjta do të sigurojë vota të mjaftueshme për ta kaluar garancinë e kredisë në parlament.

Nëse projekti miratohet, Kosova rrezikon t'i pezullohet e drejta e votës në Këshillin e Ministrave të Sekretariatit të TKE, ta dëmtojë veten në procesin e bashkimit në BE, duke qenë se nuk po e zbaton marrëveshjen e MSA, si dhe të përballet me padi në gjykatat nacionale për shkelje të ligjeve nacionale për Ndihmën Shtetërore.

Tabela 1. Përmbledhje e karakteristikave të ndihmës së dhënë në Kosovë dhe ndikimi i saj mbi konkurrencën

Emri i projektit	Forma e ndihmës	Shkelje potenciale të ligjeve të BE-së dhe TKE-së	Ndikimi në konkurrencë	Ndikimi në konkurrencë
TC Kosova e Re	Marrëveshja për Blerje të Energjisë (për 20 vite)	Neni 18 i TKE; Neni 107 i TFBK;	Nën MBE, kur projekti të hyjë në funksion, tregu i energjisë elektrike në Kosovë në esencë do të mbyllet për 20 vite, duke bllokuar kështu zhvillimin e çfarëdo konkurrence dhe minimizon shanset dhe stimujt për liberalizim të tregut të energjisë.	50 % e gjenerimit të energjisë elektrike
	Marrëveshja për blerje të njëpasnjëshme	Rregullat nga Pakoja e Tretë e Energjisë që janë miratuar nga Kosova kërkojnë nga kompanitë elektroenergjetike të jenë të hapura ndaj konkurrencës.	Furnizuesit e energjisë elektrike do të obligohet të blejnë tërë energjinë elektrike nga NKEC, duke ua pamundësuar atyre blerjen e energjisë elektrike me çmim më të ulët në treg nga Kosova apo rajoni për 20 vite	

⁴⁴ Ligji për Ndihmën Shtetërore. Neni 8. Burimi: <https://bit.ly/2vBomlO>

⁴⁵ Ligji për Ndihmën Shtetërore. Neni 13 (3). Burimi: <https://bit.ly/2vBomlO>

⁴⁶ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Bashkimit Evropian, në një të anë, dhe Kosovës në anën tjetër. Neni 77 (c). Burimi: <https://bit.ly/2UKEuAY>

Emri i projektit	Forma e ndihmës	Shkelje potenciale të ligjeve të BE-së dhe TKE-së	Ndikimi në konkurrencë	Ndikimi në konkurrencë
	Pagesa për kapacitet	Udhërrëfyeti për Ndhmë në Energji dhe Mjedis 2014 – 2020 (EEAG) përcakton se adekuacia e gjenerimit duhet të analizohet dhe kuantifikohet.	Masa e pagesës për kapacitet e vendosë GenCo në një pozitë avantazhi mbi prodhuesit tjerë të energjisë elektrike në Kosovë. Ajo nuk u ofron prodhuesve tjerë, siç është KEK-u, apo energjisë së importuar mundësinë e trajtimit të problemit të adekuacisë së gjenerimit.	
	Marrëveshja për Furnizim të Linjtit	Neni 18 i TKE; Neni 107 i TFBE;	Në bazë të kësaj marrëveshjeje, NKEC e privilegjon GenCo në furnizim të linjtit në krahasim me konkurruesit tjerë në gjenerim. Ajo i garanton thëngjillin më efikas për një çmim më të ulët, duke ua lënë konkurrentëve thëngjillin më pak efikas për një çmim më të lartë.	
	Qasja e lirë në rrjetin e gjenerimit	Neni 15 i Direktivës 2009/72/EC	Të gjitha pagesat për shfrytëzim të sistemit do t'i ngarkohen NKEC dhe jo GenCo. Prodhuesit tjerë të energjisë elektrike janë përgjegjës për t'i mbuluar këto pagesa dhe i bënë ata më pak konkurrues. Përfundimi vetëm i GenCo nga obligimi i kësaj pagese përbën diskriminim ndaj prodhuesve tjerë dhe është në kundërshtim me balancimin e bazuar në treg. Qeveria e Kosovës do të duhet ose të subvencionojë shfrytëzimin e rrjetit dhe transferimin e balancit, ose ta socializojë koston e shfrytëzimit të marrëveshjeve të njëpasnjëshme dhe më pas të njëjtat t'ia faturojë konsumatorëve fundorë.	
	Marrëveshja për transferim të lokacionit	Neni 18 i TKE; Neni 107 i TFBE;	Marrëveshja për transferimin e lokacionit përbën një tjetër rast të Ndhmës Shtetërore në këto kontrata. Qeveria e Kosovës do t'ia bartë disa pjesë të tokës shtetërore palës tjetër me një çmim që është shumë nën çmimin mesatar të tregut. Kjo do t'i japë GenCos përparësi ndaj prodhuesve tjerë të energjisë elektrike.	

3.2. Rasti i studimit – Serbi (TC Kollubara B)

Serbia është një tjetër shtet i Ballkanit që ka pasur probleme me shkeljen e dispozitave ligjore vendore dhe ndërkombëtare që mbulojnë konkurrencën dhe Ndihmën Shtetërore. Edhe pse Serbia ka ndërmarrë veprime të ndryshme legislative për të reformuar tregun e vet të brendshëm të energjisë elektrike, zbatimi i mirëfilltë i këtyre politikave mbetet sfidë. Parlamenti i Serbisë ka miratuar Ligjin e Konkurrencës dhe Ligjin për Ndhimë Shtetërore në vitin 2009.⁴⁷ Përveç kornizës ligjore për të zhvilluar më tej konkurrencën elektroenergjetike, Serbia ka investuar 28 milionë euro në Korridorin Elektroenergjetik Transballkanik (II) të rrjeteve të rrymës. Nga ky investim, 6.6 milionë (apo 24 për qind) janë marrë si grant nga Instrumenti i Paraanëtarësimit (IPA II).⁴⁸

Në vitin 2011, ndërmarrja publike (EPS) dhe kompania italiane (Edison SpA) hynë bashkërisht në një kontratë për të ndërtuar dy blloqe me nga 355MW secili brenda termocentralit Kollubara B. Investimi i gjithmbarshëm në këtë projekt supozohet të jetë mbi 2 miliardë euro.⁴⁹

Në korrik të vitit 2016, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i dërgoi letër Republikës së Serbisë për dështimin e vet për të qenë në pajtueshmëri me legjislacionin e TKE dhe BE mbi Ndhimën Shtetërore. Rasti përfshinte përkrahjen e shtetit për Elektroekonominë e Serbisë (EPS) në TC Kollubara B. Në veçanti, Sekretariati ngriti brengën se autoritetet e Serbisë kishin ofruar katër garanci shtetërore që do shfrytëzoheshin për kreditë nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe kanë transferuar pronë dhe tokë nga shteti tek EPS për tu shfrytëzuar nga projekti i TC-së.⁵⁰ Nga ky vlerësim preliminar, Sekretariati kishte konkluduar se autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit për kontrollin e Ndhimës Shtetërore kishte dështuar të vlerësojë se katër veprat e ndërmarrja nga qeveria e Serbisë ishin në shpërputhje me rregullat e përcaktuara në nenet 18 dhe 19 të TKE dhe me legjislacionin e BE-së.⁵¹ I vetmi vlerësim i shkurtër i kryer nga Komisioni për Kontroll të Ndhimës Shtetërore nuk ishte në pajtim me ligjet e BE-së.

Dy masat e para përfshinin garanci shtetërore për kredi prej 52 milionë euro për Prokurimin e Sistemit të ECS, dhe 80 milionë euro për projektin e Përmirësimit Mjedisor. Të dyja ishin masa të kërkuara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Masa e dytë përfshinte garanci shtetërore për kredi prej 90 milionë euro dhe grant prej 18 milionë euro nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW). Masa e tretë e Ndhimës Shtetërore që kishte brengosur Sekretariatit e TKE ishte transferimi i pronës dhe ndërtesës për ndërtimin e Kollubara B, me vlerë prej 12.7 milionë euro.⁵²

Në korrik të vitit 2018, në pajtim me nenin 2 mbi Procedurat për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, TKE kishte vendosur ta mbyllë rastin e Kollubara B duke qenë se Komisioni i Ndhimës Shtetërore në Serbi kishte vendosur për ta pranuar ankesën.⁵³ Dy masat e para u modifikuan ndërsa e treta u vlerësua se nuk përbën ndihmë shtetërore. Si rezultat, ky rast u mbyll ndërsa Kollubara B është në duke funksionuar.⁵⁴

47 Ligji i Konkurrencës i Serbisë (LKS). Gazeta Zyrtare Nr. 51/2009; Ligji për Kontrollin e Ndhimës Shtetërore. Gazeta Zyrtare Nr. 51/09.

48 Instrumenti i Asistencës Paraanëtarësimit (IPA II) 2014-2020. Faqe. 11. Burimi: <https://bit.ly/2RVzibD>

49 EPS pranon ofertën e Edison për ndërtimin e Kollubara B. Burimi: <https://bit.ly/2Cc7FWe>

50 Traktati i Komunitetit të Energjisë. Rasti ECS 11/14: Serbia/Ndhimë Shtetërore. Burimi: <https://bit.ly/2QQ42op>

51 Po aty

52 Përgjigja në Kërkesën e Arsytuar në Rastin ECS-11/14. Burimi: <https://bit.ly/2Eyzv1n>

53 Rasti ECS 11/14. Serbia/Ndhimë Shtetërore. Burimi: <https://bit.ly/2QQ42op>

54 Avokatia Kecic. Rasti i mbyllur: Komuniteti i Energjisë tërheqë kontestin ndaj EPS dhe Republikës së Serbisë lidhur me projektin Kollubara B. Burimi: <https://bit.ly/2DEzojz>

Tabela 2. Përmbledhje e karakteristikave të ndihmës në Serbi dhe ndikimi i saj mbi konkurrencën

Emri i projektit	Forma e ndihmës	Shkelje potenciale të ligjeve të BE-së dhe TKE-së	Ndikimi në konkurrencë	Tregu i TC-së
TC Kollubara B	Garanci shtetërore	Neni 18 dhe 19 i TKE; Neni 107 i TFBE;	Garancitë shtetërore i mundësojnë një sipërmarrje të shfrytëzojë kredi më të volitshme, duke bërë që subjektet tjera nga i njëjti sektor të jenë më pak konkurruese.	20% i TC ⁵⁵
	Garanci shtetërore	Neni 18 dhe 19 i TKE; Neni 107 i TFBE;		
	Garanci shtetërore	Neni 18 dhe 19 i TKE; Neni 107 i TFBE;		
	Garanci shtetërore	Neni 18 dhe 19 i TKE; Neni 107 i TFBE;		
	Transferim prone	Neni 18 dhe 19 i TKE; Neni 107 i TFBE;		
	Transferim lokacioni	Neni 18 dhe 19 i TKE; Neni 107 i TFBE;	Marrëveshja për transferim të lokacionit është formë e ndihmës shtetërore. Qeveria e Serbisë do t'ia bartë tokën dhe ndërtesat për një çmim shumë më të ulët se sa vlera e tregut. Kjo përbën një përparësi selektive tjetër që bën përfituesit më konkurrues se tjerët në treg.	

55 Gjenerimi nga TC në vitin 2013. Faqe 11. Burimi: <https://bit.ly/2S1nkNR>

3.3. Rasti i studimit – Bosnjë dhe Hercegovina (TC Tuzla 7)

Bosnja dhe Hercegovina (BH) është një tjetër vend i Ballkanit që për përballat me konteste lidhur me shkeljen e ligjeve të konkurrencës dhe Ndhmës Shtetërore. Ngjashëm me vendet tjera të rajonit, BH ka ndërmarrë reforma të ndryshme lidhur me konkurrencën. Në vitin 2005, Qeveria e BH ka miratuar ligjin federal mbi konkurrencën (LK)⁵⁶ e më vonë edhe Ligjin për Sistemin e Ndhmës Shtetëror, të zbatuar nga Këshilli për Ndhmë Shtetërore. Përveç ligjeve nacionale, BH, si anëtare e TKE dhe nënshkruese e MSA-së,⁵⁷ ka obligim ndërkombëtar për të zbatuar ligjet e BE-së për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore.

Pas vitesh planifikimi të ndërtimit të kapaciteteve të reja, ndërmarrja publike Elektroekonomia e Bosnjë dhe Hercegovinës (EPBiH), e cila operon me TC Tuzla, vendosi të ndërtojë një tjetër njësi të quajtur Tuzla 7 me kapacitet prej 450MW. Në nëntor të vitit 2017, EPBiH nënshkroi marrëveshje me Bankën Kineze ExIm për financim preliminar të projektit. Këshilli i Ndhmës Shtetërore të Bosnjës dhe Hercegovinës rishikoi marrëveshjen dhe tetë ditë pas pranimi të kërkesës nga Ministria Federate e Financave konkludoi se ajo ishte në pajtim me ligjet nacionale dhe ndërkombëtare mbi ndihmën shtetërore.⁵⁸ Pas informimit me vendimin e Këshillit të BeH, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i dërgoi letër deputetëve të Federatës së BeH duke i këshilluar të mos e miratojnë garancinë e kredisë prej 615 milionë euro, pasi që ajo ishte në kundërshtim me ligjet e TKE dhe BE mbi ndihmën shtetërore.⁵⁹

Sipas Sekretariatit të TKE, garancia shtetërore e kredisë e mbulon jo vetëm huanë dhe interesin por edhe “kostot tjera të ndërlidhura sipas Marrëveshjes për Linjën Kreditore.”⁶⁰ Duke marrë parasysh se kushtet e marrëveshjes nuk janë të qarta, garancia nuk mund të matet saktësisht, siç kërkohet me ligj. Përveç kësaj, Sekretariati i TKE nuk i pranoi gjetjet e Këshillit të Ndhmës Shtetërore, duke pretenduar se garancia përbën mbi 80 për qind të kredisë. Letra gjithashtu njoftonte deputetët se EPBiH nuk kualifikohet si ofrues i shërbimeve të interesit të përgjithshëm ekonomik pasi që ajo ka më shumë se një obligim të shërbimit publik dhe garancia nuk është “kompensim” për ofruesin e shërbimeve në interes të përgjithshëm ekonomik.⁶¹

Dështimi për t’iu përmbajtur obligimeve të TKE lidhur me Ndhmën Shtetërore mund të shtyjë Sekretariatit që të hapë procedurë të shkeljes ndaj Bosnjë dhe Hercegovinës. Komisioni i BE-së gjithashtu mund ta dënojë BeH në proces të anëtarësimit në BE. Mbi të gjitha, shkelja e ligjeve që rregullojnë ndihmën shtetërore përcillet me masa gjithëpërfshirëse e të kushtueshme të kthimit të ndihmës.

Projekti aktualisht është në pritje të miratimit nga parlamenti. Nëse ky projekt kalon, BeH mund të jetë një tjetër shtet që mund të humbë të drejtat e votimit në Këshillin e Ministrave të TKE si dhe të përballat me padi për ndërhyrjet.

Tabela 3. Përmbledhje e karakteristikave të ndihmës në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe ndikimi i saj mbi konkurrencën

Emri i projektit	Forma e ndihmës	Shkelje potenciale të ligjeve të BE-së dhe TKE-së	Ndikimi në konkurrencë	Tregu i TC-së
TC Tuzla 7	Garanci shtetërore	Neni 18 dhe 19 i TKE; Neni 107 i TFBE;	Garancitë shtetërore i mundësojnë një sipërmarrjeje të shfrytëzojë kredi më të volitshme, duke bërë që subjektet tjera nga i njëjti sektor të jenë më pak konkurruese.	20% ⁶²

⁵⁶ Gazeta Zyrtare e BeH, Nr. 48/05

⁵⁷ Politika Evropiane e Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit. Bosnjë dhe Hercegovina. Burimi: <https://bit.ly/2zIPVay>

⁵⁸ Bankwatch. OJQ. Burimi: <https://bit.ly/2STdFZI>

⁵⁹ Letra e TKE për deputetët e Parlamentit të Federatës së BeH. Burimi: <https://bit.ly/2rDzUPB>

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Po aty.

⁶² Bankwatch Network. Sektori i energjisë në BeH. Burimi: <https://bit.ly/2RVJXGm>

3.4. Rasti i studimit – Bulgari (TC Maritsa East 3)

Situatë e ngjashme në kuptim të shkeljeve të rregullave të Ndihmës Shtetërore në tregun e energjisë elektrike ka ngjarë në Bullgari. Dy kompani elektroenergjetike amerikane, AES dhe ContourGlobal kishin lidhur Marrëveshje për Blerje të Energjisë (MBE) me ofruesin publik të energjisë elektrike NEK për një periudhë 15-vjeçare. Dy termocentralet me thëngjill në fjalë gjenerojnë rreth 20 për qind të energjisë elektrike të Bullgarisë. AES kishte investuar 1.2 miliardë euro në një termocentral prej 670MW në kombinatin e mihjes së thëngjillit Maritsa East, në pjesën juglindore të Bullgarisë. Ky projekt filloi së operuari në vitin 2011. ContourGlobal është një kompani tjetër e cila mori përsipër operimin e një termocentrali prej 908MW në të njëjtin kompleks me kontratë të furnizimit me NEK në fuqi deri në vitin 2024.⁶³

Komisioni Shtetëror për Rregullimin e Energjisë dhe Ujërave (SEWRC) inicioi hetim mbi natyrën e MBE-ve dhe efektin e tyre në treg. Hetimi përfshi dy kontratat, një të nënshkruar mes NEK dhe AES që ishte pronare e termocentraleve Maritsa Iztoq 1 dhe tjetra ContourGlobal pronare e termocentralit Maritsa Iztoq 3. Hetimi përfundoi se metodat e obligimi të kompanisë shtetërore NEK që të blejë tërë energjinë elektrike të prodhuar nga dy kompanitë elektroenergjetike nuk është në pajtim me kërkesat e Pakos së Tretë të Energjisë.⁶⁴ Sipas SEWRC kjo i jepte kompanive amerikane avantazh konkurrues ndaj akterëve tjerë ekzistues dhe të rinj të tregut. Rregullatori tha se të dyja kontratat përbëjnë Ndihmë Shtetërore të paligjshme dhe shkelje të nenit 107 të TFBE.

Për të parandaluar pengimin e konkurrencës, në maj të vitit 2014, rregullatori i energjisë kërkoi nga NEK që t'i rinegociojë kontratat e furnizimit të energjisë elektrike. Ajo u udhëzua që të sigurojë një zbritje të çmimit prej së paku 30 për qind në kontratë, që sipas rregullatorit përbënte shkelje të rregullave të konkurrencës në Bashkimin Evropian.

Rasti i Bullgarisë do duhej t'u shërbejë PK të TKE për të mësuar mbi pasojat e rënda të cilat mund të hasen në rast se një shtet vazhdon të implementojë një projekt që përbën Ndihmë Shtetërore të palejueshme.

Tabela 4. Përmbledhje e karakteristikave të Ndihmës Shtetërore dhe ndikimit të saj mbi konkurrencën

Industria	Forma e ndihmës	Ndihma shtetërore sipas TKE dhe BE	Ndikimi në konkurrencë	Pjesa e tregut të TC
Energjia AES dhe ContourGlobal	Marrëveshje për Blerje të Energjisë (MBE) për 15 vite.	Neni 18 i TKE; Neni 107 i TFBE;	Furnizuesit e energjisë elektrike do të obligohen të blejnë tërë energjinë elektrike nga NEK, duke i privuar ata nga blerja e energjisë elektrike me çmime më të ulëta në tregun e Bullgarisë apo rajoni për një periudhë 15-vjeçare.	80%

⁶³ Seenews. Bullgaria kërkon vëmendje të shtuar nga BE mbi masat stimuluese të BRE dhe MBE me dy TC.

Burimi: <https://bit.ly/2qQqOXZ>

⁶⁴ Po aty.

3.5. Rasti i studimit - Hungari

Mes viteve të gota dhe fillimit të shekullit XXI, disa termocentrale në Hungari kishin lidhur Marrëveshje për Blerje të Energjisë me kompaninë shtetërore Magyar Villamos Művek (MVM). Në bazë të këtyre marrëveshjeve, termocentralet ia shitnin MVM tërë kapacitetin e tyre ndërsa kjo e fundit ishte përgjegjëse për t'ia furnizuar këtë energji elektrike kompanive të distribucionit. Në fillim të viteve 2000, 80 për qind e kërkesës për energji elektrike në Hungari mbulohej me MBE të tilla. Gjysma e MBE-ve (10 sish) ishin ende në fuqi në momentin kur Hungaria iu bashkua BE-së, ndërsa MBE e fundit kishte afat deri në vitin 2024. Përgjegjësitë e qeverisë sipas tyre përfshinin mbulimin e kostove operative të termocentraleve dhe pagesën e çmimeve për energji elektrike të cilat do të ishin të mjaftueshme për të siguruar normë fitimi prej 8 për qind për këto ndërmarrje. Çmimi i cili u paguhej termocentraleve përbëhej nga pagesa për kapacitet, që paguhej për kapacitete të rezervuara dhe pagesa për energji elektrike.

Komisioni i BE-së analizoi MBE-të në Hungari dhe vendosi se në bazë të ligjeve të energjisë në BE, ato përbëjnë Ndhimë Shtetërore. Vendimi i Komisionit vërente, mes tjerash, se këto MBE nuk mund të konsideroheshin sigurim i Shërbimeve të Interesit të Përgjithshëm Ekonomik (SHIPE) për sigurim të furnizimit pasi që MBE-të nuk i referohen SHIPE. Më e rëndësishëm ishte fakti që MBE-të nuk u përmbaheshin rregullit të SHIPE. MBE-të ishin selektive, të lidhura nga një sektor i veçantë dhe obligimi i blerjes i ishte imponuar një kompanie në pronë shtetërore, MVM, e cila shfrytëzon resurse shtetërore. Vendimi thekson se MBE-të e tilla shkaktojnë lëkundje në treg dhe i mbrojnë termocentralet nga çfarëdo risku operativ. Komisioni nuk pranoi argumentin se MBE-të ishin lidhur para hyrjes së Hungarisë në BE dhe se të njëjtat kanë qenë në pajtim me ligjet nacionale në kohën e lidhjes së tyre. Prandaj, Komisioni vendosi se ndihma e dhënë përbënte Ndhimë Shtetërore të palejuar dhe se MBE-të duheshin anuluar. Edhe Ndhimë Shtetërore duhej rikthyer.⁶⁵

Rasti hungarez është një shembull tjetër për PK të TKE, sepse i paraqet qartë ndërlidhimet të cilat mund të shfaqen nëse një shtet implementon një projekt me Ndhimë Shtetërore të palejueshme.

Tabela 5. Përmbledhje e karakteristikave të Ndhimës Shtetërore dhe ndikimit të saj mbi konkurrencën

Industria	Forma e ndihmës	Ndhimë shtetërore sipas TKE dhe BE	Ndikimi në konkurrencë	Pjesa e tregut të TC
Energjia 10 termocentrale të energjisë elektrike pas hyrjes së Hungarisë në BE	Marrëveshje afatgjata për Blerje të Energjisë	Neni 18 i TKE; Neni 107 i TFBE;	Furnizuesit e energjisë obligoheshin të blejnë tërë energjinë elektrike nga MWM, duke ua mohuar mundësinë e blerjes së energjisë elektrike me çmime më të ulëta në tregun hungarez apo në rajon.	20%

⁶⁵ Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian. Vendimi i Komisionit i datës 4 qershor 2008 mbi Ndhimën Shtetërore (C 41/05) të ndarë nga Hungaria përmes Marrëveshjeve për Blerje të Energjisë. Burimi: <https://bit.ly/2su3XS8>

4. Autoriteti i Ndhmës Shtetërore


Jo sikur BE, që ka procedurë të qartë për njoftime dhe autorizime të Ndhmës Shtetërore, Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë janë kryesisht të pavarura në implementimin e ligjeve të veta nacionale të Ndhmës Shtetërore.⁶⁶ Që nga viti 2009 e tutje shtetet anëtare të TKE kanë krijuar autoritetet e Ndhmës Shtetërore si pjesë e obligimeve që rrjedhin nga MSA. Shumica e këtyre autoriteteve funksionojnë si pjesë e Ministrisë së Financave dhe janë përgjegjëse për monitorimin/miratimin e projekteve në bazë të ligjeve të Ndhmës Shtetërore. Në rastet kur një ndihmë lejohet në formë të paligjshme, masa duhet ose të anulohet ose të ndryshohet, përndryshe nëse vazhdohet me të mund të vjen deri tek obligimi për ta rikthyer ndihmën.

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka monitoruar Ndhmën Shtetërore dhe u ka dhënë autoriteteve përkatëse të Palëve Kontraktuese ndihmë në implementimin e neneve 18 dhe 19 të Traktatit. Megjithatë, aftësia e Sekretariatit për të siguruar implementimin e rregullave tek Palët Kontraktuese të Traktatit është e limituar. Sfidë kryesore është transparenca e të dhënave lidhur me Ndhmën Shtetërore, në veçanti në sektorin e energjisë.⁶⁷ Sipas Raportit Vjetor të Implementimit të Sekretariatit, autoritetet e Ndhmës Shtetërore në palët kontraktuese në Ballkan nuk gëzojnë pavarësi nga qeveria. Projektet të cilat janë iniciuar nga qeveritë ose nuk janë vlerësuar fare ose janë vlerësuar gabimisht nga autoritetet e Ndhmës Shtetërore në Ballkanin Perëndimor.

MSA kërkonte formimin e autoriteteve për monitorimin e Ndhmës Shtetërore, megjithatë, ajo nuk specifikonte dizajnin operativ të këtyre autoriteteve. Prandaj, ekzaminimi i formacioneve institucionale të autoriteteve përkatëse në shtetet e Ballkanit dëshmon se ato janë ngushtë të lidhura me qeverinë.⁶⁸

Përveç mungesës së pavarësisë, autoritetet e Ndhmës Shtetërore kanë kapacitete të kufizuara njerëzore për të implementuar si duhet ligjet e Ndhmës Shtetërore. Në Raportin Vjetor të Implementimit, Sekretariati ka vlerësuar kapacitetet e autoriteteve të Ndhmës Shtetërore në të gjitha shtetet anëtare të TKE (Figura 6).

Figura 6. Vlerësimi i autoriteteve të Ndhmës Shtetërore nga Sekretariati i Komunitetit



Burimi: Raporti Vjetor i Implementimit

Konkluzion i ngjashëm për autoritetet e Ndhmës Shtetërore të vendeve të TKE nxirret edhe në Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2018. Komisioni i BE-së rithekson nevojën që autoritetet e Ndhmës Shtetërore të jenë të pavarura nga qeveria dhe të kenë punësim adekuat për të zbatuar legjislacionin e BE-së nga fusha e Ndhmës Shtetërore.

⁶⁶ Rregullat e Ndhmës Shtetërore dhe Efektiviteti i Kontrollit të Ndhmës Shtetërore në Sektorin e Energjisë nën Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Burimi: <https://bit.ly/2QD8Nvz>

⁶⁷ Raporti i Implementimit i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për vitin 2018. Burimi: <https://www.ener-gy-community.org/>

⁶⁸ Autoritetet e Konkurrencës në Evropën Juglindore. Faqe 69. Burimi: <https://bit.ly/2GvgXQP>

5. Konkluzione dhe rekomandime

Në përgjithësi, sektorët e dominuar nga ndërmarrjet publike kryesisht janë më të eksponuar ndaj intervenimeve të ndryshme shtetërore. Realizimi i metodave të ndryshme të Ndihmës Shtetërore, siç janë subvencionet, garancitë kreditore, shitja apo privatizimi i tokave publike me qëllim të promovimit të një prospekti ekonomik të një vendi ka pasur efekt destruktiv për konkurrencën. Masat e paligjshme të ndihmës shtetërore jo vetëm që çojnë dëm resurset publike por edhe pengojnë zhvillimin ekonomik të sektorit të subvencionuar. Tradicionalisht termocentralet kanë qenë në pronësi publike, prandaj ato kanë qenë më të eksponuara ndaj intervenimeve të ndryshme nga shteti.

Për këtë arsye, Bashkimi Evropian ka implementuar reforma të ndryshme rregullative për të parandaluar pengimin e konkurrencës përmes Ndihmës Shtetërore. Përveç reformave rregullative, BE, përmes programeve të ndryshme siç është Instrumenti i Konektivitetit të Evropës (CEF) ka investuar në rrjetet e interkoneksionit me qëllim të krijimit të një tregu të vetëm dhe efikas të energjisë elektrike në BE. Kosova ka qenë përfituese e granteve të ndryshme të BE-së të ndara me qëllim të modernizimit të infrastrukturës së interkoneksionit të energjisë elektrike. Si rezultat i kësaj, Kosova është një nga pak shtete të rajonit të Ballkanit Perëndimor që është integruar si duhet në tregun rajonal në kuptim të infrastrukturës.

Megjithatë, kontrata e nënshkruar rishtas mes Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë amerikane ContourGlobal ka ndikuar dukshëm në prospektin e integritetit të Kosovës në tregun elektroenergjetik të BE-së. Kjo kontratë që është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) mbi Ndihmën Shtetërore, ka bërë që rrjetet elektroenergjetike të mos japin kurrfarë efekti pasi që tregu elektroenergjetik i Kosovës do të jetë i mbyllur për 20 vite. Një Marrëveshje e ngjashme e Blerjes së Energjisë ka dëmtuar Bullgarinë dhe Hungarinë në të kaluarën. Të dyja këto vende e kanë mbyllur tregun e tyre ndaj BE-së duke shkelur kështu ligjet që rregullojnë ndarjen e Ndihmës Shtetërore. Më vonë, ato u përballën me pasoja serioze gjatë fazës së negociimit të anëtarësimit.

Shkelje të rregullave të Ndihmës Shtetërore janë gjetur edhe në vendet tjera anëtare të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Edhe pse metodat e ndihmës dallojnë, efekti i tyre është i qartë – ato pengojnë konkurrencën në fushën e energjisë elektrike në vendet e Ballkanit dhe pengojnë idenë e krijimit të një tregu të vetëm të energjisë elektrike nën kushte të barabarta veprimi për të gjithë akterët e tij.

Gjetjet e këtij punimi sugjerojnë se BE dhe Sekretariati i TKE nuk kanë qenë efektive në trajtimin e çështjes së Ndihmës Shtetërore. BE nuk i ka shfrytëzuar grantet e veta si mjete për të stimuluar shtetet e ndryshme që të zbatojnë legjislacionin e vet mbi Ndihmën Shtetërore, ndërsa juridiksioni i Sekretariatit të TKE për të parandaluar shkeljet e rregullave të Ndihmës Shtetërore është i limituar. Autoritetet nacionale të Ndihmës Shtetërore ose kanë qenë të pavullnetshme ose të paafta për të vlerësuar si duhet shkeljet e ligjeve që rregullojnë Ndihmën Shtetërore.

Në frymën e këtyre çështjeve, Instituti GAP në bashkëpunim me Institutin e Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw), rekomandojnë:

- Që BE të jetë më strikte në kuptim të rregullave të Ndhmës Shtetërore, duke qenë se ajo po e rrezikon arritjen e objektivit të gjithmbarshëm të BE-së. Komisioni i BE-së duhet të shfrytëzojë implementimin e ligjeve që rregullojnë Ndhmën Shtetërore si kushtëzim për alokimin e fondeve të paraanëtarësimit, siç janë IPA, CEF apo të përfitimeve tjera siç janë liberalizimi i vizave, etj.
- Që Traktati i Komunitetit të Energjisë të organizojë më shumë punëtori me autoritetet e Ndhmës Shtetërore pranë shteteve anëtare të veta dhe t'i trajnojë ato mbi rregullat dhe procedurat e zbatueshme për Ndhmën Shtetërore. Kjo do t'i shtonte kapacitetet hetuese dhe vendimmarrëse të Shteteve Anëtare. Raporti Vjetor i Implementimit pa ekuivokë shpërfaqë nevojën për të avancuar në implementimin e legjislacionit të BE-së për Ndhmën Shtetërore.
- Që Komisioni i BE-së të rishikojë të arriturat e vendeve të ndryshme në kuptim të luftimit të Ndhmës Shtetërore në nivel nacional. Specifikisht ai do duhej të monitorojë ekzistimin dhe shqiptimin e masave ndëshkuese për rastet e Ndhmës Shtetërore dhe të njëjtat t'i paraqesë në Raportet vjetore të Progresit.
- Që TKE dhe Komisioni i BE-së të rishqyrtojnë nëse autoritetet e Ndhmës Shtetërore janë duke implementuar rikthimin e ndihmës së palejuar dhe paligjshme.
- Që Sekretariati i TKE të iniciojë rishikimin e traktatit për të shtuar mekanizmat e zbatimit të dispozitave të Ndhmës Shtetërore pranë Palëve Kontraktuese.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,
10000 Prishtine

+381 38 609 339

info@institutigap.org

Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt mbështetet nga:



**wiiw**

The Vienna Institute for International Economic Studies
Wiener Institut für Internationale Wirtschaftsvergleiche


Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare - wiiw - është një nga qendrat kryesore për hulumtim në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore me më shumë se 40 vite eksperiencë. Gjatë viteve, wiiw ka zgjeruar ekspertizën e tij, duke e rritur mbulueshmërinë rajonale - në integrimin European, vendet e Evropës së gjerë dhe në çështje të përzgjedhura të ekonomisë globale - dhe duke zgjeruar fushat kërkimore në të cilat punon. wiiw është një institucion i pavarur, jofitimprurës. Stafi i wiiw i shërben publikut dhe klientëve pa dallim, duke publikuar analiza ekonomike dhe hulumtime, parashikime, të dhëna statistikore dhe këshilla rreth politikave.

www.wiiw.ac.at

Rahlgasse 3, 1060 Vienna, Austria

+43-1 533 66 10

wiiw@wiiw.ac.at



Ndikimi i ndihmës shtetërore në
tregun e energjisë elektrike në Ballkan